



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
Nr. 368/2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 15.07.2021 shqyrtoi ankesën përkatësisht me:

Objekt: Modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit “*Kërkesë për propozim*”, me nr. REF-93446-04-19-2021, me objekt: “*Blerje qelqurina*”, me fond limit 2.999.702,43 lekë (pa-TVSH) parashikuar për t’u zhvilluar më datë 14.05.2021, nga autoriteti kontraktor Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor, Tiranë.

Ankimues: “Almedical” ShPK.
Adresa: Rruga “Shefqet Musaraj”, Banesa nr. 17, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor.
Adresa: Rruga “Qamil Guranjaku”, Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63, të Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur në të njëjtën datë ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.3. Nuk ka respektuar shkallët e ankimit lidhur me paraqitjen e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 20.04.2021, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “Kërkesë për propozim”, me nr. REF-93446-04-19-2021, me objekt: “Blerje qelqurina”, me fond limit 2.999.702,43 lekë (pa-TVSH) parashikuar për t’u zhvilluar më datë 14.05.2021, nga autoriteti kontraktor Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor, Tiranë.

II.2. Referuar dokumentacionit dhe parashtrimeve me shkrim të operatorit ekonomik ankimues, si edhe dokumentacionit dorëzuar nga ky i fundit pjesë e ankimit pranë Komisionit të Prokurimit Publik konstatohet se më datë 26.05.2021, ky ankimues ka dërguar ankesë pranë autoritetit kontraktor ku kërkon modifikimin e dokumentave të tenderit me pretendimet si më poshtë:

Kompania “Almedical” SHPK një kompani me eksperiencë shumëvjeçare në tregun e materialeve laboratorike, kiteve, reagentëve dhe pajisjeve laboratorike e mjekësore, sikurse ka marrë pjesë dhe ka realizuar me sukses shumë kontrata me autoritete të ndryshme kontraktore është e interesuar për të marrë pjesë edhe në këtë prokurim, që zhvillohet nga ana e institucionit tuaj.

Pas shqyrtimit me kujdes të Dokumentave Standarte të Tenderit mbi kriteret ligjore dhe teknike, kompania jonë vëren disa kritere që bien në kundërshtim me qëllimet e Ligjit të Prokurimeve Publike, Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, neni 1, pika 2 c), 2 ç), 2 d):

c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;

ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;

d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;

Kështu shoqëria “Almedical” SHPK, duke pasur si qëllim të marrë pjesë në këtë procedurë, parashtron ankesën bazuar në Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ‘Për miratimin e rregullave të prokurimit publik’, i ndryshuar, si më poshtë:

Në pikën 2.3, pika c) për Kapacitetin teknik është kërkuar:

ç) Kërkohet Autodeklaratë (Deklaratë Konformiteti CE/DC) për mallrat (qelqurinat), nga ofertuesi (distributori/prodhuesi) për konformitetin me normat MDD 93/42/EC, ose 98/79 EC, ose 2015/1535/EU, kur është e aplikueshme, sipas Direktivave dhe klasifikimit të Këshillit të Europës, bashkëlidhur me kopjet të certifikatave përkatëse CE/DC (Deklaratë konformiteti), origjinale, ose fotokopje të përkthyer dhe të noterizuara, të vlefshme në momentin e hapjes dhe dorëzimit të ofertave.

Në bazë të direktivave të Këshillit Europian, kompania jonë ju bën me dije se artikujt objekt i kësaj kontrate ju nënshtrohen standarteve MDD 93/42/EC, ose 98/79 EC, ose 2015/1535/EU, kur këto produkte, sipas përkufizimeve për qëllimin e këtyre direktivave, përdoren si pajisje mjeksore apo pajisje mjeksore diagnostike in vitro.

Direktiva 2015/1535 /EU është drektive për vendosjen e një procedure për sigurimin e informacionit në fushën teknike dhe i rregullave për shërbimet e shoqërisë së informacionit.

Sipas përkufizimeve dhe fushës së aplikimit të përcaktuar në këtë direktivë, kjo direktivë nuk aplikohet tek kompanitë e prodhimit, por tek ato të shërbimit.

Në bazë të nenit 27 të VKM nr 914, pika 3: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjestim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

Ky standart 2015/1535/EU është kërkuar në kundërshtim me ligjin e prokurimeve publike ndaj kompania jonë kërkon që ky kriter të ndryshohet në:

ç) Kërkohet Autodeklaratë (Deklaratë Konformiteti CE/DC) për mallrat (qelqurinat), nga ofertuesi (distributori/prodhuesi) për konformitetin me normat MDD 93/42/EC, ose 98/79 EC, kur është e aplikueshme, sipas Direktivave dhe klasifikimit të Këshillit të Europës, bashkëlidhur me kopjet të certifikatave përkatëse CE/DC (Deklaratë konformiteti), origjinale, ose fotokopje të përkthyer dhe të noterizuara, të vlefshme në momentin e hapjes dhe dorëzimit të ofertave.

Në pikën dh) të pikës 2.3 për kapacitetin teknik është kërkuar:

dh) Për artikujt e shënuar me Asterisko (*) si më poshte, duhet të paraqiten mostra ditën e hapjes se ofertave, me date 29.04.2021 ne oren 12: 00. Dorëzimi i kampioneve/ mostrave, të bëhet pranë Sektorit

të Shërbimeve Mbështetëse pranë NJVKSH Tiranë, të mbyllura në një zarf /kuti jo transparente të vulosur mbi të cilin të shënohet:

- “Mos e hapni me përjashtim të rasteve kur është i pranishëm Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të procedurës së prokurimit « » dhe jo para datës ____ . ____ .2021, ora ____: ____.
- Së bashku me mostrat ofertuesi duhet të japë edhe një shkresë të vulosur dhe firmosur ku të listohen mostrat që ndodhen në zarf/kuti.
- Mbi çdo mostër të dorëzuar, ofertuesi duhet të shënojë Nr.Rendor të Artikullit që përfaqëson.

Nëse mostrat e dorëzuara, nuk janë të shoqëruara me listën e inventarizimit dhe të identifikuara sipas Nr. Rendor, nëse ka mungesa mostrash për artikuj të veçantë, atëherë oferta do të quhet jo e rregullt dhe rrjedhimisht do të s’kualifikohet.

Nr. rend	Emertimi	Specifikime	Njesia
1	Ambalazh njëpërdorimsh	Vakseta për marrje mostre ushqimore, sterile, 500 gr	cope
2	Ambalazh njëpërdorimsh	Me tiosulfat për marrje mostre të ujit, sterile, 250 ml	cope
3	Ambalazh njëpërdorimsh	Me tiosulfat për marrje mostre të ujit, sterile, 500 ml	cope
4*	Maja anse metalike rrethore	Me perberje nikel-krom, diameter 3-4 mm, me gjatësi 50 mm, metalike, të sterilizueshme	cope
5*	Maja anse metalike shtize	Me perberje nikel-krom, shtize, me gjatësi 40 mm, metalike, të sterilizueshme	cope
6*	Aspire	Pipetor (pump), 10 ml	cope
7	Bacinel	Mbajtëse sendesh sanitare me kapak	cope
8	Balone	I taruar, qelqi, klasi A, zjarrdruës, 1000 ml	cope
9	Balone	I taruar, qelqi, klasi A, zjarrdruës, 2000 ml	cope
10	Balone	I taruar, qelqi, klasi A, zjarrdruës, 100 ml	cope
11	Balone	I taruar, qelqi, klasi A, zjarrdruës, 250 ml	cope
12	Balone	I taruar, qelqi, klasi A, zjarrdruës, 500 ml	cope
13	Beker	I shkallezuar, qelqi Boro 3.3, zjarrdruës, 1000 ml	cope
14	Beker	I shkallezuar, qelqi Boro 3.3, zjarrdruës, 2000 ml	cope
15	Beker	I shkallezuar, qelqi Boro 3.3, zjarrdruës, 600 ml	cope
16	Beker	I shkallezuar, qelqi Boro 3.3, zjarrdruës, 250 - 300 ml	cope
17	Beker	I shkallezuar, qelqi Boro 3.3, zjarrdruës, 400 ml	cope
18	Cilinder	I shkallezuar, me ndarje 1 ml, qelqi, 100 ml	cope
19	Cilinder	I shkallezuar, me ndarje 1 ml, qelqi, 10 ml	cope
20*	Cilinder	I shkallezuar, me ndarje 1 ml, qelqi, 5 ml	cope
21*	Cilinder	I shkallezuar, me ndarje 1 ml, qelqi, 50 ml	cope
22*	Cilinder	I shkallezuar, me ndarje 1 ml, qelqi, 250 ml	cope

23*	<i>Kultiplast</i>	<i>Tampona sterile me epruvete me dimensione 12x150 mm</i>	<i>cope</i>
24	<i>Erlenmayer</i>	<i>I shkallezuar, qelqi Boro 3.3, zjarrdurues, 200 ml</i>	<i>cope</i>
25	<i>Erlenmayer</i>	<i>I shkallezuar, qelqi Boro 3.3, zjarrdurues, 300 ml</i>	<i>cope</i>
26	<i>Erlenmayer</i>	<i>I shkallezuar, qelqi Boro 3.3, zjarrdurues, 500 ml</i>	<i>cope</i>
27	<i>Furca</i>	<i>Per larjen e tubave te analizave Ø 5 mm</i>	<i>cope</i>
28	<i>Furca</i>	<i>Per larjen e tubave te analizave Ø 15 mm</i>	<i>cope</i>
29	<i>Furca</i>	<i>Per larjen e tubave te analizave Ø 25 mm</i>	<i>cope</i>
30	<i>Gershere</i>	<i>Inox te sterilizueshme</i>	<i>cope</i>
31	<i>Hinkë</i>	<i>Konike, Qelqi, Ø 70 mm</i>	<i>cope</i>
32	<i>Cilinder</i>	<i>Konik, me bazament, e shkallezuar, volum 1000 ml dhe 2000 ml</i>	<i>cope</i>
33*	<i>Kyveta</i>	<i>Qelqi Vol 3 ml per spekterfotometer UV-2100</i>	<i>cope</i>
34*	<i>Lama</i>	<i>Lama me permasa 26x76 , kuti/50 cope</i>	<i>kuti</i>
35*	<i>Lamela</i>	<i>Lamela me permasa 20x20mm, kuti/50 cope</i>	<i>kuti</i>
36*	<i>Lamela</i>	<i>Lamela me permasa (22x22), kuti/200 cope</i>	<i>kuti</i>
37	<i>Leter ambalazhi</i>	<i>Leter ambalazhi me parafine, e pa pershkueshme nga uji</i>	<i>kg</i>
38	<i>Maja pipete</i>	<i>Ependorf, sterile, 100-1000 µl, me saktesi 0.6 %</i>	<i>cope</i>
39	<i>Maja pipete</i>	<i>Ependorf, sterile, 2-200 µl, me saktesi 0.8 %</i>	<i>cope</i>
40*	<i>Magnet</i>	<i>Per perzieres magnetik per SPA Ø 12</i>	<i>cope</i>
41	<i>Pinceta</i>	<i>Te sterilizueshme, inox</i>	<i>cope</i>
42*	<i>Pjata petri</i>	<i>Plastike Φ 60 mm</i>	<i>cope</i>
43*	<i>Pjata petri</i>	<i>Plastike Φ 90 mm</i>	<i>cope</i>
44	<i>Pjata petri</i>	<i>Plastike Φ120 mm</i>	<i>cope</i>
45	<i>Puar</i>	<i>Aspir. x pipette, gome pipetimi me tre valvola</i>	<i>cope</i>
46*	<i>Shishe qelqi</i>	<i>Per marrje mostra uji, , Boro 3.3 neutral glass, me kapak te filetuar, me gryke te gjere. Volum 250 ml</i>	<i>cope</i>
47*	<i>Shishe qelqi</i>	<i>Per marrje mostra uji, Boro 3.3 neutral glass, me kapak te filetuar, me gryke te gjere, termorezistent 190 °C dhe shishja dhe kapaku. Volum 500 ml</i>	<i>cope</i>
48*	<i>Shishe qelqi</i>	<i>Per marrje mostra uji, Boro 3.3 neutral glass, me kapak te filetuar, me gryke te gjere, termorezistent 190 °C dhe shishja dhe kapaku. Volum 250 ml</i>	<i>cope</i>
49*	<i>Suport</i>	<i>Plastik per tuba me Ø 50 mm</i>	<i>cope</i>
50*	<i>Tampone</i>	<i>Tampone sterile me pambuk, me bisht druri, paketimi qese/100 cope</i>	<i>cope</i>
51	<i>Termoboks</i>	<i>Me pllake akulli, ~ 55.5 l</i>	<i>cope</i>
52*	<i>Tuba</i>	<i>Qelqi, Boro 3.3, te shkallezuar, me tape smerile, 50 ml me permasa 194x24mm me ndarje 20-50 ml</i>	<i>cope</i>
53*	<i>Tuba</i>	<i>Durhan Φ 35*6 mm</i>	<i>cope</i>

54*	Tuba	Prove, 35*6 mm, me perzjeres magnetik per SPA	cope
55*	Tuba	Qelqi, termorezistente, Φ 16*160 mm	cope
56*	Tuba	Qelqi, Φ 30*200 mm	cope
57*	Tuba	Qelqi 100 x 10	cope
58*	Tuba	Qelqi 100 x 15	cope
59*	Tuba	Qelqi 100 x 16	cope
60*	Ansa njeperdorimshe	Ansa njeperdorimshe 10 μ l shtize-unaze sterile	cope

Kriteri i vendosur nga autoriteti juaj kontraktor është diskriminues dhe pengon nxitjen e pjesmarrjes së operatorëve në këtë procedurë prokurimi, i cili është qëllimi i LPP-së sipas nenit 1, pika c) e këtij ligji: c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;

Kompania jonë me eksperiencë shumë vjeçare në tregtimin e ndër të tjerave të reagenteve kimike dhe materialeve laboratorike ka realizuar me sukses shumë kontrata dhe ka furnizuar laboratorët e institucioneve më të rëndësishme në vend në fushën e kërkimeve dhe testeve.

Duke e njohur shumë mirë përdorintin e këtyre materialeve, kompania jonë konsiston që kërkesa për mostrat e sipërpërmendura, shërben si barrierë për pjesmarrjen e operatorëve në këtë procedurë prokurimi dhe jo për vlerësimin e ofertës teknike, sikurse ligji parashikon, për arsyet si më poshtë:

1. Në pikën 2.3. pika b) për kapacitetin ligjor/profesional të operatorëve ekonomikë është kërkuar:
b) Për të gjithë artikujt e ofruar të paraqiten katalogë, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për secilin artikull (pjesët e katalogut që përmbajnë emërtimin dhe specifikimet e detajuara teknike të artikullit që ofrohet, nëse nuk janë në gjuhen shqipe, të përkthehen në gjuhen shqipe dhe të noterizohen). Operatori ekonomik duhet të markoje në katalogun përkatës produktin (ose pjesët e produktit) që ofron sipas numrit rendor (të markuara sipas artikullit) të përcaktuar në formularin e ofertës. Katalogët do pranohen vetëm në formë elektronike nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit.

Katalogu, ashtu sikurse AK ja shpreh dhe thekson në kërkesën e saj, jep në mënyrë të detajuar të gjitha specifikimet teknike të hollësishme të artikullit, duke i mundësuar AK-së vlerësimin e ofertës teknike për të gjithë artikujt e ofruara nga operatori ekonomik, përfshirë edhe artikujt e kërkuar si mostra.

Veç kësaj çdo artikull ka një kod specifik i cili i mundëson AK-së verifikimin e produktit në faqen zyrtare të kompanisë prodhuese për të gjitha informacionet shtesë për të cilin Autoriteti Kontraktor është i interesuar.

2. Të gjitha artikujt e kërkuar janë të një rëndësie të veçantë për institucionin dhe për proceset e testimin në laboratorë, ndaj zgjedhja pikërisht e këtyre materialeve, si mostra është e pajustificuar. Zgjedhja e këtyre mostrave është bërë vetëm për të krijuar barrierë për operatorët ekonomikë për shkak se materialet janë specifike dhe jo ëto gjitha mund të jenë gjendje dhe nuk mund të sillen në një afat kaq të shkurtër.

Këto artikuj janë për përdorim të përgjithshëm laboratorik dhe nuk janë artikuj që mund ti nënshtrohen ndonjë testimi nga autoriteti kontraktor.

Kërkesa për të paraqitur mostra për këto artikuj është bërë në mënyrë për të krijuar barrierë për operatorët ekonomikë që nuk kanë gjendje këto artikuj për ti paraqitur si mostra edhe pse mund të zotërojnë të gjithë kapacitetin teknik dhe profesional për të marrë pjesë në këtë procedurë.

Në nenin 27, pika 6:

6. Autoriteti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit kontraktor. Ato i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, 30 (tridhjetë) ditë pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose b) dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogjet teknike; dhe/ose

Ashtu sikurse theksuam më sipër, duke qënë se katalogët përmbajnë të gjitha të dhënat teknike, katalogët mjaftojnë që AK të vlerësojë ofertën teknikisht.

Bazuar në ligjin nr Nr. 9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar neni 20:

Autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo kriter, kërkesë apo procedurë, që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre.

Ndaj përpos më lart, kompania jonë kërkon që pika dh) e pikës 2.3 e kapacitetit teknik:

Për artikujt e shënuar me Asterisko (Y) si më poshtë, duhet të paraqiten mostra të hiqet nga kriteret.

Në shtojcën 9 të DST për specifikimet teknike kompania jonë vë re që disa specifikime teknike janë hartuar në mënyrë të tillë që të krijojnë barrierë duke iu referuar specifikimeve të një marke të caktuar apo janë përdorur edhe vetë emra markash në kundërshtim me ligjin për prokurimet publike.

Konkretisht:

Artikulli 22: Cilindër i shkallëzuar, me ndarje 1 ml, qelqi, 250 ml

Për të gjithë cilindrato është kërkuar ndarja 1 ml. Ndarja varion në bazë të vëllimit dhe cilindrato 250 ml kanë ndarje 2 ml.

Bashkangjitur kësaj ankese gjeni katalogjet e kompanive më të mëdha në botë: Duran, Brand, Labbox, Vitlab, për prodhimin e materialeve të laboratorit të cilat kanë ndarje 2 ml per cilindrato me vëllim 250 ml.

Autoriteti juaj kontraktor ka hartuar këtë specifikim për të krijuar barrierë dhe për të shmangur produktet e kompanive të tjera dhe për të përdorur si arsye për skualifikim të produkteve që do të prezantohen.

Kompania jonë kërkon ndryshimin e specifikimit teknike për këtë artikull: ndarja 2 ml.

Artikulli nr 32: Cilindër konik me vëllim 2000 ml nuk ekziston.

Përsëri ky artikull është kërkuar për të krijuar barrierë për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë dhe për të përdorur si arsye për skualifikim.

Kompania jonë kërkon që ky artikull të hiqet ose të kërkohet artikull ekuivalent 2000 ml: p.sh Erlenmajer 2000 inL

Artikulli nr 33: Kyveta qelqi 3 ml.

Kompania jonë konstaton modeli i pajisjes UV 2100, përdor kyveta me diapazon gjatësie të valës që variojnë nga 190 -1100 nm (UV/Vis).

Bazuar në modelin e kësaj pajisje, kyveta e kërkuar nga ana e Autoritetit tuaj Kontraktor mund të jetë qelq ose kuartz.

Duke përcaktuar diapazonin e gjatësisë së valës referuar modelit të pajisjes por edhe të dhënat e dritares ku vendoset kyveta përcaktohet në mënyrë të qartë kyveta që përdoret për këtë pajisje.

Kompania jonë kërkon që specifikimet teknike të kyvetës bazuar në modelin e pajisjes që do të përdoret: të ndryshojnë në: të përcaktohen dimensionet e dritares të pajisjes ku do të vendoset kyveta të jetë diapazoni i gjatësisë së valës dhe të ndryshohet lloji i materialit të kyvetes në qelq /kuartz.

Artikulli 38 dhe 39 - Maja pipete Ependorf sterile, 100-1000 µl, me saktësi 0.6 % dhe 2 - 100 µl 0.8 %.

Kompania jonë konstaton përsëri që specifikimet teknike dhe emri i markës së përdorur janë hartuar në kundërshtim me ligjin e prokurimeve në mënyrë të tillë që të pengojnë pjesëmarrjen.

Në bazë të nenit 23 pika 5 të LPP-së

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë marke apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët "ose ekuivalent" të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Kompania jonë kërkon përqindja e saktësisë 0.6 % dhe 0.8 % për majat a pipetave të hiqet sepse saktësia nuk jepet për majat e pipetave por për pipetat për të cilat përdoret: këto maja pipetash dhe janë specifike të markës që kanë vendosur referencë.

Artikulli 52 – Tuba Qelqi, Boro 3.3 të shkallëzuar, me tapë smerile, 50 ml me përmasa 194x24 mm me ndarje 20-50 ml.

Kompania jonë konstaton që përsëri specifikimet teknike të këtij artikulli janë hartuar në mënyrë të tillë që të krijojnë barrierë për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në këtë procedurë prokurimi.

Tubat e qelqit nuk janë pjesë apo aksesori i një aparature dhe përmasat fikse 194x 24 mm të tubave është kërkuar në mënyrë të tillë që të eliminojnë produktet e kompanive të tjera në kundërshtim me ligjin e prokurimeve publike.

Kompania jonë kërkon që ky specifikim teknik 194 x 24 mm për këtë artikull të hiqet ose të përdoret termi afërsisht në këto përmasa.

*Artikulli 54 Tuba Prove, 35*6 mm, me përzjerës magnetik për SPA.*

Ky specifikim teknik i kërkuar nuk qëndron teknikisht.

Tubat nuk janë të shoqëruar me përzjerës magnetik ndaj kompania jonë kërkon që ky specifikim teknik me përzjerës magnetik për SPA të hiqet.

Në lidhje me artikujt:

Nr 1: Ambalazh një përdorimsh - Kompania jonë kërkon të sqarohet specifikimi 500 gr.

Në rast se vasketa përdoret për rrarrjen e mostrës duhet të jepet vëllimi në ml dhe jo në gr dhe në rast se kërkohet për peshimin e mostrës atëherë të specifikohet dhe të kërkohet pesha 500 gr.

Nr 2: Letër ambalazhi - Kërkon korrigjimin të njësisë së produktit. Letrat e ambalazhit kanë jepen në njësinë rolo ndaj kërkohet që njësia e këtij artikulli të ndryshojë në rolo.

Bazuar në sa më sipër kompania jonë rikujton edhe njëherë nenin 20 të ligjit nr Nr. 9643, datë 20.11.2006:

Autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo kriter, kërkesë apo procedurë, që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre.

II.5. Në datën 12.05.2021 operatori ekonomik “Almedical” ShPK ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, duke kërkuar modifikimin e dokumentave të tenderit me të njëjtat pretendime si ato të parashtruara pranë autoritetit kontraktor, si më poshtë vijon:

“Kompania jonë “Almedical” SHPK një kompani me eksperiencë shumëvjeçare në tregun e materialeve laboratorike, kiteve, reagentëve dhe pajisjeve laboratorike e mjekësore, sikurse ka marrë pjesë dhe ka realizuar me sukses shumë kontrata me autoritete të ndryshme kontraktore është e interesuar për të marrë pjesë edhe në këtë prokurim, që zhvillohet nga Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Tiranë, që zhvillohet sipas shtojcës për modifikim më datë 14/05/2021.

Kjo procedurë prokurimi është publikuar më datë 20.04.2021.

Kompania jonë pas njohjes me dokumentat standarte të tenderit dhe kriteret e kualifikimit sipas nenit 63, pika 1, të LPP: Çdo person që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund të kundërshtojë vendimin ju drejtua fillimisht AK me ankesë për të kundërshtuar kritere të cilat janë hartuar në kundërshtim me ligjin e prokurimeve publike, dhe shërbejnë si barrierë për pjeseëmarrje.

Kompania jonë parashtroi pranë AK ankesën si më poshtë: Në pikën 2.3, pika c) për Kapacitetin teknik është kërkuar:

ç) Kërkohet Autodeklaratë (Deklaratë Konformiteti CE/DC) për mallrat (qelqurinat), nga ofertuesi (distributori/prodhuesi) për konformitetin me normat MDD 93/42/EC, ose 98/79 EC, ose 2015/1535/EU, kur është e aplikueshme, sipas Direktivave dhe klasifikimit të Këshillit të Europës, bashkëlidhur me kopjet të certifikatave përkatëse CE/DC (Deklaratë konformiteti), origjinale, ose fotokopje të përkthyer dhe të noterizuara, të vlefshme në momentin e hapjes dhe dorëzimit të ofertave.

Në bazë të direktivave të Këshillit Europian, kompania jonë u bën me dije se artikujt objekt i kësaj kontrate ju nënshtrohen standarteve MDD 93/42/EC, ose 98/79 EC, ose 2015/1535/EU, kur këto produkte, sipas përkufizimeve për qëllimin e këtyre direktivave, përdoren si pajisje mjeksore apo pajisje mjeksore diagnostike in vitro.

Direktiva 2015/1535 /Eu është drektive për vendosjen e një procedure për sigurimin e informacionit në fushën teknike dhe i rregullave për shërbimet e shoqërisë së informacionit.

Sipas përkufizimeve dhe fushës së aplikimit të përcaktuar në këtë direktivë, kjo direktivë nuk aplikohet tek kompanitë e prodhimit, por tek ato të shërbimit.

Në bazë të nenit 27 të VKM nr 914, pika 3: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjestim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

Ky standart 2015/1535/EU është kërkuar në kundërshtim me ligjin e prokurimeve publike ndaj kompania jonë kërkon që ky kriter të ndryshohet në:

ç) Kërkohet Autodeklaratë (Deklaratë Konformiteti CE/DC) për mallrat (qelqurinat), nga ofertuesi (distributori/prodhuesi) për konformitetin me normat MDD 93/42/EC, ose 98/79 EC, kur është e aplikueshme, sipas Direktivave dhe klasifikimit të Këshillit të Europës, bashkëlidhur me kopjet të certifikatave përkatëse CE/DC (Deklaratë konformiteti), origjinale, ose fotokopje të përkthyer dhe të noterizuara, të vlefshme në momentin e hapjes dhe dorëzimit të ofertave.

Në pikën dh) të pikës 2.3 për kapacitetin teknik është kërkuar:

dh) Për artikujt e shënuar me Asterisko (*) si me poshte, duhet të paraqiten mostra ditën e hapjes se ofertave, me date 29.04.2021 ne oren 12: 00. Dorëzimi i kampioneve/ mostrave, të bëhet prane Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse pranë NJVKSH Tiranë, te mbyllura ne nje zarf /kuti jo transparente te vulosur mbi te cilin te shenohet:

- “Mos e hapni me përjashtim te rasteve kur është i pranishëm Komisioni i Vlerësimit te Ofertave te procedurës se prokurimit « » dhe jo para dates _____.____.2021, ora ____: ____.
- Se bashku me mostrat ofertuesi duhet te japë edhe një shkresë te vulosur dhe firmosur ku te listohen mostrat qe ndodhen ne zarf/kuti.
- Mbi çdo mostër te dorëzuar, ofertuesi duhet te shënoje Nr.Rendor te Artikullit qe përfaqëson.

Nëse mostrat e dorëzuara, nuk janë të shoqëruara me listën e inventarizimit dhe të identifikuara sipas Nr. Rendor, nëse ka mungesa mostrash për artikuj të veçantë, atëherë oferta do të quhet jo e rregullt dhe rrjedhimisht do të s'kualifikohet.

<i>Nr. rend</i>	<i>Emertimi</i>	<i>Specifikime</i>	<i>Njesia</i>
1	<i>Ambalazh njeperdorimsh</i>	<i>Vakseta per marrje mostre ushqimore, sterile, 500 gr</i>	<i>cope</i>
2	<i>Ambalazh njeperdorimsh</i>	<i>Me tiosulfat per marrje mostre te ujit, sterile, 250 ml</i>	<i>cope</i>
3	<i>Ambalazh njeperdorimsh</i>	<i>Me tiosulfat per marrje mostre te ujit, sterile, 500 ml</i>	<i>cope</i>
4*	<i>Maja anse metalike rrethore</i>	<i>Me perberje nikel-krom, diameter 3-4 mm, me gjatesi 50 mm, metalike, te sterilizueshme</i>	<i>cope</i>
5*	<i>Maja anse metalike shtize</i>	<i>Me perberje nikel-krom, shtize, me gjatesi 40 mm, metalike, te sterilizueshme</i>	<i>cope</i>
6*	<i>Aspire</i>	<i>Pipetor (pump), 10 ml</i>	<i>cope</i>
7	<i>Bacinel</i>	<i>Mbajtese sendesh sanitare me kapak</i>	<i>cope</i>
8	<i>Balone</i>	<i>I taruar, qelqi, klasi A, zjarrdruues, 1000 ml</i>	<i>cope</i>
9	<i>Balone</i>	<i>I taruar, qelqi, klasi A, zjarrdruues, 2000 ml</i>	<i>cope</i>
10	<i>Balone</i>	<i>I taruar, qelqi, klasi A, zjarrdruues, 100 ml</i>	<i>cope</i>
11	<i>Balone</i>	<i>I taruar, qelqi, klasi A, zjarrdruues, 250 ml</i>	<i>cope</i>
12	<i>Balone</i>	<i>I taruar, qelqi, klasi A, zjarrdruues, 500 ml</i>	<i>cope</i>
13	<i>Beker</i>	<i>I shkallezuar, qelqi Boro 3.3, zjarrdruues, 1000 ml</i>	<i>cope</i>
14	<i>Beker</i>	<i>I shkallezuar, qelqi Boro 3.3, zjarrdruues, 2000 ml</i>	<i>cope</i>
15	<i>Beker</i>	<i>I shkallezuar, qelqi Boro 3.3, zjarrdruues, 600 ml</i>	<i>cope</i>
16	<i>Beker</i>	<i>I shkallezuar, qelqi Boro 3.3, zjarrdruues, 250 - 300 ml</i>	<i>cope</i>
17	<i>Beker</i>	<i>I shkallezuar, qelqi Boro 3.3, zjarrdruues, 400 ml</i>	<i>cope</i>
18	<i>Cilinder</i>	<i>I shkallezuar, me ndarje 1 ml, qelqi, 100 ml</i>	<i>cope</i>
19	<i>Cilinder</i>	<i>I shkallezuar, me ndarje 1 ml, qelqi, 10 ml</i>	<i>cope</i>
20*	<i>Cilinder</i>	<i>I shkallezuar, me ndarje 1 ml, qelqi, 5 ml</i>	<i>cope</i>
21*	<i>Cilinder</i>	<i>I shkallezuar, me ndarje 1 ml, qelqi, 50 ml</i>	<i>cope</i>
22*	<i>Cilinder</i>	<i>I shkallezuar, me ndarje 1 ml, qelqi, 250 ml</i>	<i>cope</i>
23*	<i>Kultiplast</i>	<i>Tampona sterile me epruvete me dimensione 12x150 mm</i>	<i>cope</i>
24	<i>Erlenmayer</i>	<i>I shkallezuar, qelqi Boro 3.3, zjarrdruues, 200 ml</i>	<i>cope</i>
25	<i>Erlenmayer</i>	<i>I shkallezuar, qelqi Boro 3.3, zjarrdruues, 300 ml</i>	<i>cope</i>
26	<i>Erlenmayer</i>	<i>I shkallezuar, qelqi Boro 3.3, zjarrdruues, 500 ml</i>	<i>cope</i>
27	<i>Furca</i>	<i>Per larjen e tubave te analizave Ø 5 mm</i>	<i>cope</i>
28	<i>Furca</i>	<i>Per larjen e tubave te analizave Ø 15 mm</i>	<i>cope</i>
29	<i>Furca</i>	<i>Per larjen e tubave te analizave Ø 25 mm</i>	<i>cope</i>
30	<i>Gershere</i>	<i>Inox te sterilizueshme</i>	<i>cope</i>

31	<i>Hinkë</i>	<i>Konike, Qelqi, Ø 70 mm</i>	<i>cope</i>
32	<i>Cilinder</i>	<i>Konik, me bazament, e shkallezuar, volum 1000 ml dhe 2000 ml</i>	<i>cope</i>
33*	<i>Kyveta</i>	<i>Qelqi Vol 3 ml per spekterfotometer UV-2100</i>	<i>cope</i>
34*	<i>Lama</i>	<i>Lama me permasa 26x76 , kuti/50 cope</i>	<i>kuti</i>
35*	<i>Lamela</i>	<i>Lamela me permasa 20x20mm, kuti/50 cope</i>	<i>kuti</i>
36*	<i>Lamela</i>	<i>Lamela me permasa (22x22), kuti/200 cope</i>	<i>kuti</i>
37	<i>Leter ambalazhi</i>	<i>Leter ambalazhi me parafine, e pa pershkueshme nga uji</i>	<i>kg</i>
38	<i>Maja pipete</i>	<i>Ependorf, sterile, 100-1000 µl, me saktesi 0.6 %</i>	<i>cope</i>
39	<i>Maja pipete</i>	<i>Ependorf, sterile, 2-200 µl, me saktesi 0.8 %</i>	<i>cope</i>
40*	<i>Magnet</i>	<i>Per perzieres magnetik per SPA Ø 12</i>	<i>cope</i>
41	<i>Pinceta</i>	<i>Te sterilizueshme, inox</i>	<i>cope</i>
42*	<i>Pjata petri</i>	<i>Plastike Φ 60 mm</i>	<i>cope</i>
43*	<i>Pjata petri</i>	<i>Plastike Φ 90 mm</i>	<i>cope</i>
44	<i>Pjata petri</i>	<i>Plastike Φ120 mm</i>	<i>cope</i>
45	<i>Puar</i>	<i>Aspir. x pipette, gome pipetimi me tre valvola</i>	<i>cope</i>
46*	<i>Shishe qelqi</i>	<i>Per marrje mostra uji, , Boro 3.3 neutral glass, me kapak te filetuar, me gryke te gjere. Volum 250 ml</i>	<i>cope</i>
47*	<i>Shishe qelqi</i>	<i>Per marrje mostra uji, Boro 3.3 neutral glass, me kapak te filetuar, me gryke te gjere, termorezistent 190 °C dhe shishja dhe kapaku. Volum 500 ml</i>	<i>cope</i>
48*	<i>Shishe qelqi</i>	<i>Per marrje mostra uji, Boro 3.3 neutral glass, me kapak te filetuar, me gryke te gjere, termorezistent 190 °C dhe shishja dhe kapaku. Volum 250 ml</i>	<i>cope</i>
49*	<i>Suport</i>	<i>Plastik per tuba me Ø 50 mm</i>	<i>cope</i>
50*	<i>Tampone</i>	<i>Tampone sterile me pambuk, me bisht druri, paketimi qese/100 cope</i>	<i>cope</i>
51	<i>Termoboks</i>	<i>Me pllake akulli, ~ 55.5 l</i>	<i>cope</i>
52*	<i>Tuba</i>	<i>Qelqi, Boro 3.3, te shkallezuar, me tape smerile, 50 ml me permasa 194x24mm me ndarje 20-50 ml</i>	<i>cope</i>
53*	<i>Tuba</i>	<i>Durhan Φ 35*6 mm</i>	<i>cope</i>
54*	<i>Tuba</i>	<i>Prove, 35*6 mm, me perzjeres magnetik per SPA</i>	<i>cope</i>
55*	<i>Tuba</i>	<i>Qelqi, termorezistente, Φ 16*160 mm</i>	<i>cope</i>
56*	<i>Tuba</i>	<i>Qelqi, Φ 30*200 mm</i>	<i>cope</i>
57*	<i>Tuba</i>	<i>Qelqi 100 x 10</i>	<i>cope</i>
58*	<i>Tuba</i>	<i>Qelqi 100 x 15</i>	<i>cope</i>
59*	<i>Tuba</i>	<i>Qelqi 100 x 16</i>	<i>cope</i>
60*	<i>Ansa njeperdorimshe</i>	<i>Ansa njeperdorimshe 10 µl shtize-unaze sterile</i>	<i>cope</i>

Kriteri i vendosur nga autoriteti juaj kontraktor është diskriminues dhe pengon nxitjen e pjesmarrjes së operatorëve në këtë procedurë prokurimi, i cili është qëllimi i LPP-së sipas nenit 1, pika c) e këtij ligji: c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;

Kompania jonë me eksperiencë shumë vjeçare në tregtimin e ndër të tjerave të reagenteve kimike dhe materialeve laboratorike ka realizuar me sukses shumë kontrata dhe ka furnizuar laboratorët e institucioneve më të rëndësishme në vend në fushën e kërkimeve dhe testimeve.

Duke e njohur shumë mirë përdorintin e këtyre materialeve, kompania jonë konsiston që kërkesa për mostrat e sipërpërmendura, shërben si barrierë për pjesmarrjen e operatorëve në këtë procedurë prokurimi dhe jo për vlerësimin e ofertës teknike, sikurse ligji parashikon, për arsyet si më poshtë:

1. Në pikën 2.3. pika b) për kapacitetin ligjor/profesional të operatorëve ekonomikë është kërkuar:

b) Për të gjithë artikujt e ofruar te paraqiten katalogë, ku te përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për secilin artikull (pjesët e katalogut që përmbajnë emërtimin dhe specifikimet e detajuara teknike të artikullit që ofertohe, nëse nuk janë në gjuhën shqipe, të përkthehen në gjuhën shqipe dhe të noterizohen). Operatori ekonomik duhet të markojë në katalogun përkatës produktin (ose pjesët e produktit) që ofron sipas numrit rendor (të markuara sipas artikullit) të përcaktuar në formularin e ofertës. Katalogët do pranohen vetëm në formë elektronike nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit.

Katalogu, ashtu sikurse AK ja shpreh dhe thekson në kërkesën e saj, jep në mënyrë të detajuar të gjitha specifikimet teknike të hollësishme të artikullit, duke i mundësuar AK-së vlerësimin e ofertës teknike për të gjithë artikujt e ofruara nga operatori ekonomik, përfshirë edhe artikujt e kërkuar si mostra.

Veç kësaj çdo artikull ka një kod specifik i cili i mundëson AK-së verifikimin e produktit në faqen zyrtare të kompanisë prodhuese për të gjitha informacionet shtesë për të cilin Autoriteti Kontraktor është i interesuar.

2. Të gjitha artikujt e kërkuar janë të një rëndësie të veçantë për institucionin dhe për proceset e testimit në laboratorë, ndaj zgjedhja pikërisht e këtyre materialeve, si mostra është e pajustificuar. Zgjedhja e këtyre mostrave është bërë vetëm për të krijuar barrierë për operatorët ekonomikë për shkak se materialet janë specifike dhe jo ëto gjitha mund të jenë gjendje dhe nuk mund të sillen në një afat kaq të shkurtër.

Këto artikuj janë për përdorim të përgjithshëm laboratorik dhe nuk janë artikuj që mund të nënshtrohen ndonjë testimi nga autoriteti kontraktor.

Kërkesa për të paraqitur mostra për këto artikuj është bërë në mënyrë për të krijuar barrierë për operatorët ekonomikë që nuk kanë gjendje këto artikuj për të paraqitur si mostra edhe pse mund të zotërojnë të gjithë kapacitetin teknik dhe profesional për të marrë pjesë në këtë procedurë.

Në nenin 27, pika 6:

6. Autoriteti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit kontraktor. Ato i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, 30 (tridhjetë) ditë pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose b) dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogjet teknike; dhe/ose

Ashtu sikurse theksuam më sipër, duke qënë se katalogët përmbajnë të gjitha të dhënat teknike, katalogët mjaftojnë që AK të vlerësojë ofertën teknikisht.

Bazuar në ligjin nr Nr. 9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar neni 20:

Autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo kriter, kërkesë apo procedurë, që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre.

Ndaj përpos më lart, kompania jonë kërkon që pika dh) e pikës 2.3 e kapacitetit teknik:

Për artikujt e shënuar me Asterisko (Y) si më poshtë, duhet të paraqiten mostra të hiqet nga kriteret.

Në shtojcën 9 të DST për specifikimet teknike kompania jonë vë re që disa specifikime teknike janë hartuar në mënyrë të tillë që të krijojnë barriera duke iu referuar specifikimeve të një marke të caktuar apo janë përdorur edhe vetë emra markash në kundërshtim me ligjin për prokurimet publike.

Konkretisht:

Artikulli 22: Cilindër i shkallëzuar, me ndarje 1 ml, qelqi, 250 ml

Për të gjithë cilindrat është kërkuar ndarja 1 ml. Ndarja varion në bazë të vëllimit dhe cilindrat 250 ml kanë ndarje 2 ml.

Bashkangjitur kësaj ankese gjeni katalogjet e kompanive më të mëdha në botë: Duran, Brand, Labbox, Vitlab, për prodhimin e materialeve të laboratorit të cilat kanë ndarje 2 ml per cilindrat me vëllim 250 ml.

Autoriteti juaj kontraktor ka hartuar këtë specifikim për të krijuar barrierë dhe për të shmangur produktet e kompanive të tjera dhe për të përdorur si arsye për skualifikim të produkteve që do të prezantohen.

Kompania jonë kërkon ndryshimin e specifikimit teknike për këtë artikull: ndarja 2 ml.

Artikulli nr 32: Cilindër konik me vëllim 2000 ml nuk ekziston.

Përsëri ky artikull është kërkuar për të krijuar barrierë për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë dhe për të përdorur si arsye për skualifikim.

Kompania jonë kërkon që ky artikull të hiqet ose të kërkohet artikull ekuivalent 2000 ml: p.sh Erlenmajer 2000 inL

Artikulli nr 33: Kyveta qelqi 3 ml.

Kompania jonë konstaton modeli i pajisjes UV 2100, përdor kyveta me diapazon gjatësie të valës që variojnë nga 190 -1100 nm (UV/Vis).

Bazuar në modelin e kësaj pajisje, kyveta e kërkuar nga ana e Autoritetit tuaj Kontraktor mund të jetë qelq ose kuartz.

Duke përcaktuar diapazonin e gjatësisë së valës referuar modelit të pajisjes por edhe të dhënat e dritares ku vendoset kyveta përcaktohet në mënyrë të qartë kyveta që përdoret për këtë pajisje.

Kompania jonë kërkon që specifikimet teknike të kyvetës bazuar në modelin e pajisjes që do të përdoret: të ndryshojnë në: të përcaktohen dimensionet e dritares të pajisjes ku do të vendoset kyveta, të jetë diapazoni i gjatësisë së valës dhe të ndryshohet lloji i materialit të kyvetes në qelq /kuartz.

Artikulli 38 dhe 39 - Maja pipete Ependorf sterile, 100-1000 µl, me saktësi 0.6 % dhe 2 - 100 µl 0.8 %

Kompania jonë konstaton përsëri që specifikimet teknike dhe emri i markës së përdorur janë hartuar në kundërshtim me ligjin e prokurimeve në mënyrë të tillë që të pengojnë pjesmarrjen.

Në bazë të nenit 23 pika 5 të LPP-së

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë marke apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët "ose ekuivalent" të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Kompania jonë kërkon përqindja e saktësisë 0.6 % dhe 0.8 % për majat a pipetave të hiqet sepse saktësia nuk jepet për majat e pipetave por për pipetat për të cilat përdoret: këto maja pipetash dhe janë specifike të markës që kanë vendosur referencë.

20-50 ml

Kompania jonë konstaton që përsëri specifikimet teknike të këtij artikulli janë hartuar në mënyrë të tillë që të krijojnë barriera për pjesmarrjen e operatorëve ekonomikë në këtë procedurë prokurimi.

Tubat e qelqit nuk janë pjesë apo aksesori i një aparature dhe përmasat fikse 194x 24 mm të tubave është kërkuar në mënyrë të tillë që të eliminojnë produktet e kompanive të tjera në kundërshtim me ligjin e prokurimeve pubike.

Kompania jonë kërkon që ky specifikim teknik 194 x 24 mm për këtë artikull të hiqet ose të përdoret termi afërsisht në këto përmasa.

*Artikulli 54 Tuba Prove, 35*6 mm, me përzjerës magnetik për SPA.*

Ky specifikim teknik i kërkuar nuk qëndron teknikisht.

Tubat nuk janë të shoqëruar me përzjerës magnetik ndaj kompania jonë kërkon që ky specifikim teknik me përzjerës magnetik për SPA të hiqet.

Në lidhje me artikujt:

Nr 1: Ambalazh një përdorimsh - Kompania jonë kërkon të sqarohet specifikimi 500 gr.

Në rast se vasketa përdoret për rnarrjen e mostrës duhet të jepet vëllimi në ml dhe jo në gr dhe në rast se kërkohet për peshimin e mostrës atëherë të specifikohet dhe të kërkohet pesha 500 gr.

Nr 2: Letër ambalazhi - Kërkon korrigjiin të njësisë së produktit. Letrat e ambalazhit kanë jepen në njësinë rolo ndaj kërkojmë që njësia e këtij artikulli të ndryshojë në rolo.

Bazuar në sa më sipër kompania jonë rikujton edhe njëherë nenin 20 të ligjit nr Nr. 9643, datë 20.11.2006:

Autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo kriter, kërkesë apo procedurë, që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre.

Sipas ligjit të prokurimeve publike për procedurat e ankimit administrativ, neni 63, pika 1, kompania jonë ju drejtua fillimisht AK me ankesë për DST:

1.1 Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni.

Kompania jonë iu drejtua me ankesë AK më datë 26.05.2021, brenda afateve të përcaktuara në ligjin e prokurimeve.

Sipas pikës 5, neni 63 i LPP:

5. Autoriteti kontraktor shqyrton ankesën dhe merr një vendim të arsyetuar brenda 7 ditëve pas marrjes së ankesës, të cilin duhet t'ia njoftojë ankuesit jo më vonë se në ditën vijuese të punës.

Pra, Autoriteti Kontraktor duhej të na kthente përgjigje në bazë të këtij afati deri në datën 03.05.2021 dhe kompania jonë ishte në pritje të kësaj përgjigje për të pranuar vendimin e AK ose për t'ju drejtuar KPP-së për kundërshtimin e vendimit sikurse parashikon ligji dhe brenda afateve të përcaktuara.

Kompania jonë nuk ka marrë asnjë përgjigje nga Autoriteti Kontraktor në lidhje me ankesën tonë.

Me datë 11.05.2021 kompania jonë u njoh në sistem të prokurimeve me njoftimin që procedura e prokurimit u hoq nga pezullimi pas ezaurimit të afateve për ankimim në KPP.

Sipas kësaj shtojce Autoriteti Kontraktor thotë që na ka pranuar pjesërisht ankesën për të cilën ka hedhur një shtojcë për modifikim më datë 28.04.2021.

Informacionet që jep AK në këtë shtojcë janë kontradiktore:

Së pari, në nuk kemi marrë asnjë përgjigje nga ana e Autoritetit Kontraktor.

Së dyti, në shtojcën 28.04.2021, nuk ka asnjë modifikim referuar pikave të ankesës sonë ndaj përsëri nuk kuptohet çfarë pikash pretendon që ka pranuar Autoriteti Kontraktor kur shprehet që na ka pranuar ankesën pjesërisht

Së treti, afatet e ankimit nuk janë ezauruar sepse në bazë të pikës 6 të nenit 63 të LPP-së:

6. Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim e ankesës i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor.

Pra afati për përgjigjen nga ana e Autoritetit Kontraktor ka qënë data 03.05.2021.

Sipas nenit 6 afati për ankimim për në KPP në rast se ankesa nuk shqyrtohet nga ana e Autoritetit Kontraktor brenda afatit prej 7 ditësh është 10 ditë nga dita e nesërme e punës pas përfundimit të afatit.

Pra nga data 04.05.2021 deri me 14.05.2021 (për shkak se data 13.05.2021 është feste zyrtare).

Pra afatet për ankimim nuk janë ezauruar.

Kompania jonë nëpërmjet kësaj ankese kërkon nga Komisioni i Prokurimeve Publike shqyrtimin e ankesës sonë të plotë, pasi kompania jonë nuk ka marrë asnjë përgjigje nga ana e Autoritetit Kontraktor.

3. Pretendimi i ankuesit për vendimin përfundimtar

Çfarë e vendimi kërkon të marrë Komisioni?

- Të hiqet standarti 2015/1535/EU sepse ka lidhje me shoqëritë e shërbimit dhe jo tregtimit.
- Te hiqet kriteri për mostrat sepse katalogjet verifikojnë çdo specifikim teknik të kërkuar.
- Të ndryshohen specifikimet teknike të cilat janë referenca markash dhe shërbejnë si barrierë, sipas kërkesave dhe argumentave të parashtruar në ankesë.”.

II.6. Nëpërmjet shkresës nr.2999/25 prot, datë 08.04.2020, protokolluar me tonën me nr. 321/2 prot datë 09.04.2020 është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimes. Autoriteti kontraktor në informacionin dhe dokumentacionin e paraqitur pranë KPP-së sqaron se:

Në vijim po ju bëjmë me dije informacion mbi procedurën me objekt: “Blerje Qelqurina, me nr. REF-93446-04-19-2021, në zbatim të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 794/2, datë 18.05.2021, administruar pranë NJVKSH Tiranë me nr. 1055 prot, datë 24.05.2021.

lu sqarojmë se më datë 19.04.2021, ne SPE është publikuar nga Autoriteti Kontraktor “NJVKSH Tiranë”, Njoftimi i Kontratës dhe Dokumentat e Tenderit, me datë të hapjes/dorëzimit të ofertave datën 30.04.2021.

Në mbështetje të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar, Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar neni 63, pika 1.1 ku citohet: Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomik mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Ju bëjmë me dije se:

Pranë Autoritetit Kontraktor, brenda 7 (shtatë) ditësh është paraqitur vetëm një ankesë nga operatori ekonomik "Krijon" ShPK administruar pranë NJVKSH Tiranë me nr. 880 prot, datë 26.04.2021.

Pas marrjes së ankesës autoriteti kontraktor ndoqi të gjitha hapat e përcaktuara në LPP dhe RPP për trajtimin e ankesës, duke pezulluar procedurën me shkresën nr. 881 prot, datë 26.04.2021, shqyrtuar ankesën e paraqitur dhe kthimin e përgjigjes operatorit ankimues me shkresën nr. 881/3 prot, datë 28.04.2021. Në vijim autoriteti kontraktor, në respektim të afateve për paraqitjen e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik, e mbajti të pezulluar procedurën deri në përfundimin e këtyre afateve. **Duke qenë se pranë autoritetit kontraktor, Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Tiranë, nuk është paraqitur asnjë ankimim tjetër përveç ankimit të sipërcituar nga operatori ekonomik "Krijon" ShPK.**

Autoriteti vijoi me hapat e mëtejshme si më poshtë cituar:

1- Ç'pezullimin e procedurës me anë të shkresës nr 966 prot, datë 11.05.2021.

2- Shtyrjen e afatit të hapjes së ofertave

3- Hapjen e ofertave në datën 14.05.2021

4- Vlerësimin e ofertave të paraqitura në sistemin e prokurimeve elektronike datë 19.05.2021.

Theksojmë se pranë autoritetit kontraktor, Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Tiranë, nuk është paraqitur asnjë ankesë nga operatori ekonomik "Almedical" ShPK për dokumentet e tenderit, të cilit i është referuar Komisioni i Prokurimit Publik.

Me ardhjen e shkresës nga ana juaj, Autoriteti Kontraktor nëpërmjet urdhërit nr 1056 prot, datë 24.05.2021 bëri pezullimin e procedurës.

Përsa më sipër statusi aktual i kësaj procedure deri në marrjen e shkresës Tuaj ka qenë në afat ankimimi në lidhje me vlerësimin.

Mbetemi në pritje të një vendimi nga ana juaj për një mbarëvajtje sa më të mirë të procedurës së prokurimit.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.”.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur

Arsyeton

III.1. Në datën 20.04.2021, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “*Kërkesë për propozim*”, me nr. REF-93446-04-19-2021, me objekt: “*Blerje qelqurina*”, me fond limit 2.999.702,43 lekë (pa-TVSH) parashikuar për t’u zhvilluar më datë 14.05.2021, nga autoriteti kontraktor Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor, Tiranë.

III.1.1. Operatori ekonomik ankimues pretendon se në datën 26.05.2021 (Lapsus i ankimuesit, pasi referuar dëftesës postare datë 26.04.2021, me Bar-Kod: EB629708812AA, bashkalidhur Formularit të Ankesës rezulton se është dorëzuar më datë 26.04.2021) ka dërguar ankesë pranë autoritetit kontraktor ku kërkon modifikimin e dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimimi.

III.1.2. Referuar informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor me nr. 1083 prot., datë 25.05.2021, të depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik në datën 27.05.2021, me **nr. 794/3 prot**, informohet se ankesa e operatorit ekonomik ankimues “Almedical” ShPK nuk është dorëzuar pranë zyrave të autoritetit kontraktor Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Tiranë, me adresë si në vijim: “*Rruga “Qamil Guranjaku”, Tiranë*”, adresë e publikuar nga ana e autoritetit kontraktor në dokumentat e tenderit dhe njoftimin e kontratës, të publikuara në Sistemin Elektronik të Prokurimit (SPE).

III.1.3. Në datën 12.05.2021 operatori ekonomik “Almedical” ShPK ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, duke kërkuar modifikimin e dokumentave të tenderit me të njëjtat pretendime si ato të parashtruara pranë autoritetit kontraktor.

Gjithashtu, ankimuesi pretendon se nuk ka përgjigje nga ana e autoritetit kontraktor.

III.1.4. Autoriteti kontraktor Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor, Tiranë nëpërmjet shkresës nr.1083 prot, datë 25.05.2021, protokolluar me tonën me **nr. 794/3 prot**, datë 27.05.2021, informoi Komisionin e Prokurimit Publik, se për procedurën e mësipërme të prokurimit nuk është dorëzuar ankesë nga ana e operatorit ekonomik “Almedical” ShPK.

III.1.5. Komisioni i Prokurimit Publik ndodhur para faktit ku operatori ekonomik ankimues pretendon se ka dërguar ankesë pranë autoritetit kontraktor, si dhe para faktit ku autoriteti kontraktor Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Tiranë pretendon se nuk është dorëzuar ankesë nga operatori ekonomik “Almedical” ShPK, fakte të cilat janë kontradiktore dhe thelbësore për legjitimitimin e ankimuesit të procedurën e ankimimit, kërkoi informacion nga Posta Shqiptare SH.A me shkresën **nr. 794/4 prot**, datë 31.05.2021 (*shkresë drejtuar për dijeni autoritetit kontraktor Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Tiranë me adresë si në vijim: “Rruga “Qamil Guranjaku”, Tiranë”, si dhe operatorit ekonomik “Almedical” ShPK, me adresë si në vijim: “Rruga ‘Shefqet Musaraj’, Banesa Nr.17, Tiranë*”), si më poshtë vijon:

“*Të nderuar,*

Komisioni i Prokurimit Publik, pas depozitimit të ankesës të operatorit ekonomik “Almedical” SHPK ka nisur hetimin administrativ për procedurën e prokurimit “Kërkesë për propozim”, me nr. REF-

93446-04-19-2021, me objekt: “Blerje qelqurina”, me fond limit 2.999.702,43 lekë (pa-TVSH) parashikuar për t’u zhvilluar më datë 14.05.2021, nga autoriteti kontraktor Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor, Tiranë.

Operatori ekonomik ankimes “Almedical” SHPK, në ankesën e paraqitur pretendon se më datë 26.05.2021, ka dërguar ankesë pranë autoriteti kontraktor, Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor, Tiranë, nëpërmjet shërbimit ekspres të Postës Shqiptare, me dëftesën postare “DËFTESË-PRANIMI KONFIRMIM MARRJE E OBJEKTIT EKSPRES I BRENDSHËM” numër serial: 004339, datë 26/04/2021, me KOD-BAR: EB629708812AA. (Bashkëlidhur dëftesa postare)

Ndërkohë autoriteti kontraktor, Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor, Tiranë, pretendon se nuk i ka mbërritur dërgesa postare e sipërpërmendur.

Të ndodhur në këto kushte dhe me qëllim gjykimin sa më drejtë dhe transparent të ankesës së paraqitur, si dhe në zbatim të nenit 115/5, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” kërkojmë nga Institucioni juaj të na japi informacion lidhur me dërgesën postare të sipërpërmendur, si më poshtë:

1- Në cilën datë është dorëzuar dërgesa postare në protokollin e autoriteti kontraktor, Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor, Tiranë.

2- Emrin e personit që ka marrë në dorëzim dërgesën postare.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.”.

III.1.6. Në datën 14.06.2021, Posta Shqiptare SH.A me shkresën nr. 1168/1 prot, datë 11.06.2021 protokolluar me tonën me **nr. 794/5 prot**, datë 14.06.2021, (shkresë drejtuar për dijeni autoritetit kontraktor Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Tiranë me adresë si në vijim: “Rruga “Qamil Guranjaku”, Tiranë” dhe operatorit ekonomik “Almedical” ShPK, me adresë si në vijim: “Rruga “Shefqet Musaraj”, Banesa Nr.17, Tiranë”) na informoi si më poshtë vijon:

“Në përgjigje të ankesës tuaj nr.1168 prot, datë 02.06.2021, drejtuar Postës Shqiptare Sh.A, lidhur me mos dorëzimin e objektit postar institucionit të adresuar, sqarojmë se Referuar Rregullores Bazë të Shërbimit Postar, sipas nenit.51 pika 51.2, objektet postare të cilat i'u drejtohen titullarëve apo vetë institucioneve, dorëzohen në Sekretaritë e Institucioneve respektive.

Neni 51 Shpërndarja e objekteve postare pika 51.2 “Objektet postare të të gjitha llojeve që i'u adresohen institucioneve apo firmave të ndryshme, si dhe punonjësve të tyre, dorëzohen në sektorin e administratës së tyre. Objektet e regjistruara, letrat me lajmërim marije, si dhe lajmërimi për letrat me vlerë të deklaruar, dorëzohen kundrejt nënshkrimit të plotë të punonjësit të sektorit të administrimit.”.

Subjekti "Almedica" ka depozituar në zyrën postare nr.5 Tiranë, në datën 26.04.2021, ora 11.50 am, objektin postar me barkod EB629708812AA në adresë të Njesisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor Tiranë. Ky objekt është dorëzuar brenda ditës, datë 26.04.2021, ora 12.31 pm, pranë Institucionit të Njesisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor, Tiranë. Marrja në dorëzim është nënshkruar nga personi i autorizuar i institucionit, M.V.

Pas dorëzimit të objektit në adresë, në zyrën postare ku subjekti ka depozituar zarfin, është kthyer e firmosur nga marrësi konfirmimi i lajmërim dorëzimit të objektit postar.

Bashkëlidhur gjeni fotokopjen e konfirmimit të lajmërim dorëzimit të objektit postar. Ju faleminderit për mirëkuptimin.”.

Ndërkohë shkresës së sipërpërmendur i mungonte fotokopja e konfirmimit të lajmërim dorëzimit të objektit postar.

III.1.7. Autoriteti kontraktor Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor, Tiranë, duke marrë shkas nga shkresa e Postës Shqiptare SH.A nr. 1168/1 prot, datë 11.06.2021, nëpërmjet shkresës nr.1256/1 prot, datë 14.06.2021, protokolluar me tonën me **nr. 794/7 prot**, datë 15.06.2021, informoi Komisionin e Prokurimit Publik, si më poshtë vijon:

“Duke marrë shkas nga shkresa e ardhur nga Drejtoria e Shërbimeve Postare me nr. 1168/1 prot, datë 11.06.2021, administruar në protokollin tonë me nr. 1256 prot, datë 14.06.2021 me lëndë "Kthim përgjigje" me anë të së cilës institucioni jonë është vënë në dijeni, ju bëjmë me dije si më poshtë vijon:

Në organikën e institucionit tonë nuk ka punonjës me emrin Marsida Velo dhe si rrjedhojë kjo ankesë nuk ka ardhur pranë institucionit tonë.

Ju bëjmë me dije se në ambjentët e Njesisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor Tiranë janë 2 institucione më vete me protokolle të veçanta përkatësisht, Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Tiranë dhe Drejtoria Rajonale e Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor. Pranë protokollit të institucionit tonë nuk është depozituar asnjë shkresë nga Drejtoria Rajonale e Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor.

Bashkëngjitur po ju dërgojmë organikën e Njesisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor Tiranë dhe Urdhërin për mbulimin e shërbimit pranë zyrës së protokollit te Znj. A. P.

Mbetemi në pritje të një vendimi nga ana juaj për një mbarëvajtje sa më të mirë të procedurës së prokurimit.”.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.”.

III.1.8. Komisioni i Prokurimit Publik ndodhur para faktit ku shkresës së Postës Shqiptare SH.A me nr. 1168/1 prot, datë 11.06.2021, i mungon fotokopja e konfirmimit të lajmërim dorëzimit të objektit postar, si dhe ndodhur para faktit ku autoriteti kontraktor Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Tiranë pretendon se nuk është dorëzuar ankesë nga operatori ekonomik “Almedical” ShPK, fakte të cilat janë kontradiktore dhe thelbësore për legjitimitimin e ankimuesit të procedurën e ankimimit, rikërkoji informacion nga Posta Shqiptare SH.A me shkresën **nr. 794/8 prot**, datë 18.06.2021 (shkresë drejtuar për dijeni autoritetit kontraktor Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Tiranë me adresë si në vijim: “Rruga “Qamil Guranjaku”, Tiranë”, si dhe operatorit ekonomik “Almedical” ShPK, me adresë si në vijim: “Rruga ‘Shefqet Musaraj’, Banesa Nr.17, Tiranë”), si më poshtë vijon:

“Të nderuar,

Komisioni i Prokurimit Publik, pas depozitimit të ankesës të operatorit ekonomik “Almedical” SHPK ka nisur hetimin administrativ për procedurën e prokurimit “Kërkesë për propozim”, me nr. REF-93446-04-19-2021, me objekt: “Blerje qelqurina”, me fond limit 2.999.702,43 lekë (pa-TVSH)

parashikuar për t'u zhvilluar më datë 14.05.2021, nga autoriteti kontraktor Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor, Tiranë dhe me shkresën nr. 794/4 prot, datë 31.05.2021 kërkoi informacion pranë Institucionit të Postës Shqiptare Sh.A.

Institucioni juaj me shkresën nr. 1168/1 prot, datë 11.06.2021, protokolluar pranë Institucionit tonë me nr. 794/5 prot, datë 14.06.2021, u njoh me përgjigjen tuaj, por kësaj shkresë i mungonte bashkalidhur fotokopja e konfirmimit të lajmërim dorëzimit të objektit postar.

Ndërkohë autoriteti kontraktor, Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor, Tiranë, me shkresën nr. 1256 prot, datë 14.06.2021, protokolluar pranë Institucionit tonë me nr. 794/7 prot, datë 15.06.2021, rithekson pretendimin e saj se nuk i ka mbërritur dërgesa postare nëpërmjet shërbimit ekspres të Postës Shqiptare, me dëftesën postare “DËFTËSË-PRANIMI KONFIRMIM MARRJE E OBJEKTIT EKSPRES I BRENDSHËM” numër serial: 004339, datë 26/04/2021, me KOD-BAR: EB629708812AA. Të ndodhur në këto kushte dhe me qëllim gjykimin sa më drejtë dhe transparent të ankesës së paraqitur, si dhe në zbatim të nenit 115/5, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” me shkresën nr. 794/4 prot, datë 31.05.2021, në vijim të komunikimit kërkojmë nga Institucioni juaj të na vini në dispozicion dokumentacionin dhe informacion lidhur me dërgesën postarë të sipërpërmendur, si më poshtë:

1- Fotokopjen e konfirmimit të lajmërim dorëzimit të objektit postar me numër serial: 004339 datë 26/04/2021, me KOD-BAR: EB629708812AA.

2- Informacion se në cilën adresë është dorëzuar dërgesa postare e sipërpërmendur.

3- Informacion se në cilin ambient të Institucionit Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Tiranë është dorëzuar dërgesa postare e sipërpërmendur.

Meqënëse informacioni juaj është i rëndësishëm për mbarëvajtjen e punës së Komisionit të Prokurimit Publik dhe deri më sot nuk është dërguar nga ana juaj, ju rikërkojmë që të na dërgoni informacionin e sipërkërkuar.

Në mungesë të paraqitjes së informacionit të kërkuar, mbështetur në nenin 131, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i cili parashikon shprehimisht: “Refuzimi i autoritetit ose entit kontraktor për të bashkëpunuar me Komisionin e Prokurimit Publik dhe Agjencinë e Prokurimit Publik ngarkon me përgjegjësi titullarin e autoritetit kontraktor dhe dënohet nga këto institucione me gjobë nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) deri në 500 000 (pesëqind mijë) lekë.”, Komisioni i Prokurimit Publik do të kërkojë marrjen e menjëhershme të masave disiplinore për personat përgjegjës.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,”.

III.1.9. Në datën 29.06.2021, Posta Shqiptare SH.A me shkresën nr. 1168/3 prot, datë 28.06.2021 protokolluar me tonën me nr. **794/9 prot**, datë 29.06.2021, (shkresë drejtuar për dijeni autoritetit kontraktor Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Tiranë me adresë si në vijim: “Rruga “Nasi Pavllo” Tiranë”, operatorit ekonomik “Almedical” ShPK, me adresë si në vijim: “Rruga “Shefqet Musaraj” Banesa Nr.17, Tiranë” dhe autoritetit kontraktor Operatori Rajonal i Kujdesit Shëndetësor Tiranë me adresë si në vijim: “Rruga “Nasi Pavllo”, Tiranë”) na informoi si më poshtë vijon:

“Në përgjigje të suajës nr.794/8 prot, datë 18.06.2021, drejtuar Postës Shqiptare Sh.a, lidhur me mos dorëzimin e objektit postar institucionit të adresuar, sqarojmë:

Subjekti "Almedica" ka depozituar në zyrën postare nr. 5 Tiranë, në datën 26.04.2021, ora 11 :50 objektin postar me barkod EB629708812AA në adresë të Njesisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor Tiranë.

Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor me adresë Rruga "Nasi Pavllo" Tiranë, ndodhet në të njëjtën ndërtesë me Operatorin Rajonal Shëndetësor Tiranë. Korrierin e Postës Shqiptare e kanë orientuar te sekretaria, ku ka dorëzuar letrën të konfirmuar nga Znj. M. V.

Nga verifikimet e kryera pranë këtij institucioni, konfirmohet se punonjësja e sekretarisë i përket Operatorit Rajonal Shëndetësor Tiranë. Kjo punonjëse, pasi ka hapur zarfin ka konstatuar se dokumentacioni i përkiste Njesisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor Tiranë dhe menjëherë këtë zarf e ka dorëzuar personalisht në Njësinë Vendore të Kujdesit Shëndetësor, por pa e shoqëruar me një dokument zyrtar të konfirmimit të dorëzimit.

Bashkëlidhur gjeni fotokopjen e konfirmimit të lajmërim dorëzimit të objektit postar.

Ju faleminderit për mirëkuptimin.”.

III.1.10. Autoriteti kontraktor Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor, Tiranë, duke marrë shkas nga shkresa e Postës Shqiptare SH.A nr. 1168/3 prot, datë 11.06.2021, nëpërmjet shkresës nr.1523/1 prot datë 29.06.2021, protokolluar me tonën me **nr. 794/10 prot**, datë 30.06.2021, informoi Komisionin e Prokurimit Publik, si më poshtë vijon:

“Duke marrë shkas nga shkresa e ardhur nga Drejtoria e Shërbimeve Postare me nr. 1168/3 prot, datë 28.06.2021 administruar në protokollin tonë me nr. 1523 prot, datë 29.06.2021, me lëndë “Kthim përgjigje” me anë të së cilës institucioni jonë është vënë në dijeni si më poshtë vijon:

Ju sjellim sërish në vëmendjen tuaj se nga provat shkresore rezulton qartë se shkresa është dorëzuar pranë Drejtorisë Rajonale të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor me adresë Rruga “Qamil Guranjaku” dhe është marrë në dorëzim nga punonjësja e këtij institucioni. Rikonfirmojmë edhe njëherë se pranë institucionit Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Tiranë as në rrugë zyrtare e as dorazi nuk është paraqitur kjo shkresë ashtu siç dëshmojnë qartë provat e sipërpërmendura dhe në protokollin e institucionit tonë nuk ka asnjë regjistrim të shkresës dhe asnjë marrje në dorëzim të kësaj shkrese nga ana e punonjësës së protokollit. Duke qënë se është detyrim ligjor i protokollit të një insitucioni të rregjistrojë ose të refuzojë pranimin e një shkrese me një arsyetim të caktuar, fakti që kjo shkresë nuk figuron në asnjë lloj formati në institucionin tonë do të thotë që nuk është paraqitur pranë këtij institucioni.

Përsa më sipër Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Tiranë në zbatim dhe në respektim të të gjitha dispozitave ligjore në fuqi për prokurim ka vijuar me procedurën e prokurimit. Në mungesë të fakteve të provuara me dokumentacion shkresor për regjistrim ose dorëzim të kësaj shkrese pranë institucionit tonë, Ju lutemi merrni në konsideratë kërkesën tonë për zgjidhje sa më të shpejtë të kësaj çështje, pasi institucioni jonë është në mungesë të objektit të procedurës në fjalë, duke na penguar kështu mbarëvajtjen e punës në këtë institucion.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.”.

III.1.11. Komisioni i Prokurimit Publik, pasi konstatoi faktin se në shkresën e Postës Shqiptare SH.A me nr. 1168/3 prot, datë 28.06.2021, shfaqet adresë tjetër e autoritetit kontraktor Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Tiranë dhe konkretisht adresa si në vijim: “Rruga “Nasi Pavllo”, Tiranë”, ju drejtua me kërkesë për sqarim Postës Shqiptare SH.A me shkresën **nr. 794/11 prot**, datë 01.07.2021 (shkresë drejtuar për dijeni autoritetit kontraktor Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Tiranë me adresë si në vijim: “Rruga “Qamil Guranjaku”, Tiranë”, si dhe operatorit ekonomik “Almedical” ShPK, me adresë si në vijim: “Rruga ‘Shefqet Musaraj”, Banesa Nr.17, Tiranë”), si më poshtë vijon:

“Të nderuar,

Komisioni i Prokurimit Publik, pas depozitimit të ankesës të operatorit ekonomik “Almedical” SHPK ka nisur hetimin administrativ për procedurën e prokurimit “Kërkesë për propozim”, me nr. REF-93446-04-19-2021, me objekt: “Blerje qelqurina”, me fond limit 2.999.702,43 lekë (pa-TVSH) parashikuar për t’u zhvilluar më datë 14.05.2021, nga autoriteti kontraktor Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor, Tiranë dhe me shkresën nr. 794/4 prot datë 31.05.2021 kërkoi informacion pranë Institucionit të Postës Shqiptare Sh.A.

*Institucioni juaj me shkresën nr. 1168/3 prot, datë 28.06.2021, protokolluar pranë Institucionit tonë me nr. 794/9 prot, datë 29.06.2021, u njoh me përgjigjen tuaj, ku citohet se: “... Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor me adresë **Rruga “Nasi Pavllo” Tiranë**, ndodhet në të njëjtën ndërtesë me Operatorin Rajonal Shëndetësor Tiranë. ...”.*

Ndërkohë adresa e autoriteti kontraktor, Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Tiranë e publikuar në dokumentat e tenderit të procedurës së mësipërme të prokurimit është si në vijim: “Rruga “Qamil Guranjaku”, Tiranë.”.

Të ndodhur në këto kushte dhe me qëllim gjykimin sa më drejtë dhe transparent të ankesës së paraqitur, në zbatim të nenit 115/5, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në vijim të komunikimit kërkojmë nga Institucioni juaj të na vini në dispozicion dokumentacionin dhe informacion lidhur me dërgesën postarë të sipërpërmendur si më poshtë:

1- Adresa e përmendur në shkresën tuaj nr. 1168/3 prot, datë 28.06.2021, protokolluar pranë Institucionit tonë me nr. 794/9 prot, datë 29.06.2021, është lapsus apo është adresa e saktë e autoritetit kontraktor Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Tiranë?

2- Nëse është lapsus na sqaroni se në cilën adresë të Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Tiranë është komunikuar dërgesa postare nëpërmjet shërbimit ekspres të Postës Shqiptare, me dëftesën postare “DËFTËSË-PRANIMI KONFIRMIM MARRJE E OBJEKTIT EKSPRES I BRENDSHËM” numër serial: 004339, datë 26/04/2021, me KOD-BAR: EB629708812AA.

Meqënëse informacioni juaj është i rëndësishëm për mbarëvajtjen e punës së Komisionit të Prokurimit Publik dhe deri më sot nuk është dërguar nga ana juaj, ju rikërkojmë që të na dërgoni informacionin e sipërkërkuar.

Në mungesë të paraqitjes së informacionit të kërkuar, mbështetur në nenin 131, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i cili parashikon shprehimisht: “Refuzimi i autoritetit ose entit kontraktor për të bashkëpunuar me Komisionin e Prokurimit Publik dhe Agjencinë e Prokurimit Publik ngarkon me përgjegjësi titullarin e autoritetit kontraktor dhe dënohet nga këto institucione me gjobë nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) deri në 500 000 (pesëqind mijë) lekë.”, Komisioni i Prokurimit Publik do të kërkojë marrjen e menjëhershme të masave disiplinore për personat përgjegjës.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.”.

III.1.12. Në datën 12.07.2021, Posta Shqiptare SH.A me shkresën nr. 1168/5 prot, datë 12.07.2021 protokolluar me tonën me nr. 794/12 prot, datë 13.07.2021, (shkresë drejtuar për dijeni autoritetit kontraktor Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Tiranë me adresë si në vijim: “Rruga “Nasi Pavllo” Tiranë”, operatorit ekonomik “Almedical” ShPK, me adresë si në vijim: “Rruga ‘Shefqet Musaraj’ Banesa Nr.17, Tiranë” dhe autoritetit kontraktor Operatori Rajonal i Kujdesit Shëndetësor Tiranë me adresë si në vijim: “Rruga “Nasi Pavllo”, Tiranë”) na informoi si më poshtë vijon:

“Në përgjigje suajës nr.794/11 prot, datë 01.07.2021 drejtuar Postës Shqiptare Sh.a, lidhur me dorëzimin e objektit postar institucionit të adresuar, sqarojmë:

Posta Shqiptare e ka dorëzuar objektin postar me barkod EB629708812AA (të Subjektit "Almedica") në Njësinë Vendore të Kujdesit Shëndetësor Tiranë, në godinën me adresë: Rruga "Nasi Pavllo" Tiranë.”.

III.1.13. Në nenin 40, të Ligjit Nr. 46/2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë” i cili përcaktohen rregullat për ofrimin dhe sigurimin e shërbimeve postare dhe shërbimin universal postar, si dhe të drejtat dhe detyrimet e ofruesve dhe përdoruesve të shërbimeve postare në Republikën e Shqipërisë, ku përcaktohet se:

“Neni 40 “Shpërndarja dhe dorëzimi i objekteve postare”

1. Objektet postare dorëzohen në njërën nga këto adresa të marrësit:

- a) në banesën e tij;*
- b) në ambientet e punës ose të biznesit;*
- c) në kutinë postare, të vendosur në ambientet përkatëse.*

2. Objektet e regjistruara dhe të siguruar dorëzohen në adresën e marrësit. Nëse kjo nuk është e mundur, një objekt postar i regjistruar dhe i siguruar i dorëzohet një anëtar i me moshë madhore të familjes, në banesën e tij, ose personit të autorizuar në ambientin e punës/biznesit ose te një person i autorizuar nga marrësi.

3. Nëse dorëzimi i objekteve postare nuk është i mundur, sipas pikës 2, të këtij neni, për shkak të mungesës së tyre, shpërndarësi lëshon një njoftim në adresën e parashikuar në pikën 1, të këtij neni, duke specifikuar vendin e marrjes dhe afatin kohor, në të cilin këto objekte postare mund të tërhiqen.

4. Nëse marrësi i objekteve postare nuk arrin të marrë objektin postar brenda afatit kohor, të specifikuar në njoftimin referuar pikës 3, të këtij neni, objekti postar do të kthehet te dërguesi jashtë vendit, sipas dispozitave të Konventës së UPU-së dhe rregullores në zbatim të saj.

5. Nëse marrësi ose personat e referuar në pikën 2, të këtij neni, refuzojnë të pranojnë një objekt postar të regjistruar dhe siguruar, shpërndarësi shënon mbi objektin postar datën dhe arsyen e refuzimit dhe i kthen mbrapsht dërguesit objektin postar.

6. Në rast se një objekt postar nuk mund të dorëzohet te marrësi dhe në rast se dërguesi nuk mund të identifikohet, ofruesi i shërbimit postar lëshon një shënim zyrtar mbi objektin postar. Ky objekt ruhet për një periudhë 1-vjeçare nga data në të cilën lihet shënim zyrtar.

7. Nëse marrësi është analfabet ose ai/ajo nuk mund të firmosë dëftesën e dorëzimit, shpërndarësi shënon emrin e marrësit, duke përfshirë një shënim ku të specifikohet arsyeja e mosfirmosjes nga ana e marrësit e dëftesës së dorëzimit.”.

III.1.14. Me Vendimin nr. 13, datë 30.06.2020, Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, i është dhënë autorizimi individual shoqërisë “Posta Shqiptare” SH.A për të ofruar shërbimin universal postar në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, sipas dokumentit bashkëlidhur këtij vendimi, për një periudhë 5 vjeçare duke filluar nga data 7 korrik 2020.

III.1.15. Komisioni i Prokurimit Publik sjell në vëmendje nenin 63, pika 1, 2, 5 dhe 6, të Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në të cilin është parashikuar:

“1. Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.

1.1 Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni.

2. Ankesa kundër vendimeve të autoritetit kontraktor i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji.

5. Autoriteti kontraktor shqyrton ankesën dhe merr një vendim të arsyetuar brenda 7 ditëve pas marrjes së ankesës, të cilin duhet t’ia njoftojë ankuesit jo më vonë se në ditën vijuese të punës.

6. Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimuesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim e ankesës i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor.”.

III.1.16. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në fashikullin e shqyrtimit administrative, si edhe pretendimeve të ankimuesit, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se shoqëria ankimuese ka dorëzuar ankesën drejtuar autoritetit kontraktor Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Tiranë pranë shoqërisë “Posta Shqiptare” SH.A, vërtetuar kjo me dëftesën postare “DËFTESË-PRANIMI KONFIRMIM MARRJE E OBJEKTIT POSTAR” me numër serial: 004339, datë 26.04.2021, me KOD-BAR: EB629708812AA, pasi shoqëria “Posta Shqiptare” SH.A është e autorizuar nga Agjencia e Komunikimeve Elektronike dhe Postare për të ofruar shërbimin universal postar në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, dhe që në zbatim të nenit 40, të Ligjit Nr. 46/2015 “Për shërbimet postare në

Republikën e Shqipërisë” ka detyrimin që objektet e marra në dorëzim t’i dorëzojë në adresën e marrësit dhe nëse kjo nuk është e mundur, një objekt postar i regjistruar dhe i siguruar i dorëzohet një anëtarit me moshë madhore të familjes, në banesën e tij, ose personit të autorizuar në ambientin e punës/biznesit ose te një person i autorizuar nga marrësi. Ndërkohë nga hetimi i kryer nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, konstatohet se dërgesa postare e sipërpërmendur nuk është dorëzuar nga shoqëria “Posta Shqiptare” SH.A pranë personit të autorizuar nga titullari i autoritetit kontraktor Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Tiranë dhe konkretisht pranë personit përgjegjës të zyrës së protokollit Znj. A. P, por është dorëzuar në institucionin e Drejtorisë Rajonale të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor dhe konkretisht është marrë në dorëzim nga punonjësja e këtij institucioni Znj. M. V, fakt i cili pranohet nga vetë shoqëria “Posta Shqiptare” SH.A me shkresat nr. 1168/1 prot, datë 11.06.2021 dhe nr. 1168/3 prot, datë 28.06.2021, protokolluar përkatësisht me tonat me nr. 794/5 prot, datë 14.06.2021 dhe nr. 794/9 prot, datë 29.06.2021.

Gjithashtu nga hetimi i kryer nga Komisioni i Prokurimit Publik, nga shqyrtimi i organikës së autoritetit kontraktor Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Tiranë dërguar me shkresën nr. 1256/1 prot, datë 14.06.2021, protokolluar me tonën me numër 794/7 prot, datë 15.06.2021, konstatohet se Znj. M. V e cila ka marrë në dorëzim dërgesën postare të sipër përmendur nuk është punonjëse e institucionit të Njesisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor Tiranë.

Ndërkohë lidhur me pretendimin e shoqërisë “Posta Shqiptare” SH.A se: *“Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor me adresë Rruga “Nasi Pavllo” Tiranë ndodhet në të njëjtën ndërtesë me Operatorin Rajonal Shëndetësor Tiranë. Korierin e Postës Shqiptare e kanë orientuar te sekretaria, ku ka dorëzuar letrën të konfirmuar nga Znj. M. V. Nga verifikimet e kryera pranë këtij institucioni, konfirmohet se punonjësja e sekretarisë i përket Operatorit Rajonal Shëndetësor Tiranë. Kjo punonjëse, pasi ka hapur zarfin ka konstatuar se dokumentacioni i përkiste Njesisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor Tiranë dhe menjëherë këtë zarf e ka dorëzuar personalisht në Njesisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor Tiranë, por pa e shoqëruar me një dokument zyrtar.”*, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se ndonëse dërgesa postare e sipërpërmendur është adresuar për tu dorëzuar tek autoritetit kontraktor Njësia Vendore të Kujdesit Shëndetësor Tiranë, punonjësi i shoqërisë “Posta Shqiptare” SH.A në mosrespektim të përcaktimeve ligjore e ka dorëzuar në institucionin e Operatorit Rajonal Shëndetësor Tiranë dhe jo në adresën e vendosur në këtë dërgesë postare.

Lidhur me kërkesën e Komisionit të Prokurimit Publik drejtuar shoqërisë “Posta Shqiptare” SH.A me shkresën nr. 794/11 prot, datë 01.07.2021, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se adresa në të cilën është komunikuar dërgesa postare e sipërpërmendur është adresa: *“Rruga “Nasi Pavllo” Tirane”* dhe jo adresa e autoritetit kontraktor Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Tiranë si në vijim: *“Rruga ‘Qamil Guranjaku’ Tiranë”*, e përcaktuar nga ana e këtij të fundit në dokumentat e tenderit objekt prokurimi të publikuara në Sistemin Elektronik të Prokurimit.

Gjithashtu Komisioni i Prokurimit Publik i sjell në vëmendje autoritetit kontraktor se njësia e prokurimit është përgjegjëse për hartimin e dokumentave të tenderit, pasi jo vetëm duhet të përdori dokumentat standarte të miratuara nga Agjencia e Prokurimit Publi, por duhet ti hartojë ato duke i

plotësuar me saktësi rubrikat që i takojnë autoritetit kontraktor përfshirë dhe vendosjen e adresës së saktë të autoritetit kontraktor.

III.1.17. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, ligjvënësi ka parashikuar detyrimin e operatorëve ekonomikë për të dorëzuar ankesën për dokumentat e tenderit pranë autoritetit kontraktor ndërkohë që mënyra se si do ta dorëzojë këtë ankesë operatori ekonomik është lënë në vlerësimin e vetë ankimuesit.

III.1.18. Në nenin 82 pika 1 të Ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSh”, i ndryshuar, parashikohet se: “Në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj.”. Në rastin konkret, operatori ekonomik ankimues nuk ka depozituar pranë autoritetit kontraktor një ankesë të hartuar në formën e përcaktuar në ligj – formë shkresore, ç’ka rrjedhimisht sjell që ai të mos ketë përmbushur detyrimin për ndjekien e të gjitha shkallëve të ankimimit, duke mos plotësuar në këtë mënyrë kërkesën e nenit 63, pika 1 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ndërkohë që dëftesa postare bashkalidhur ankesës nuk është provë që vërteton dorëzimin e ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe për më tepër që mos dorëzimi i ankesës ka ardhur edhe për shkak të mos dërgimit të kësaj ankese nga ana e shoqërisë “Posta Shqiptare” SH.A, sipas përcaktimeve ligjore.

III.1.19. Komisioni i Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij se, për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve (ndër to dhe ai i ankimimit), është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullimit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si lex specialis mbi lëndën.

III.1.20. Duke mbajtur në konsideratë faktin që, sipas ligjit në fuqi, shqyrtimi administrativ i nënshtrohet dy fazave: asaj të shqyrtimit paraprak (në të cilin vlerësohen forma e ankimit, legjitimitimi, juridiksioni, kompetenca dhe nuk i jepet zgjidhje në thelb ankimit) dhe asaj të shqyrtimit në themel të ankimit, në rastin në fjalë, ankimi administrativ i paraqitur nga operatori ankimues pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik nuk mund të konsiderohet si ezaurim i shkallëve të ankimimit sipas kushteve formale si edhe afateve ligjore që duhet të ndjekë një ankim administrativ pasi, jo për faj të vetë ankimuesit, ankimimi nuk është realizuar sipas kriterëve të domosdoshme të përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

III.2. Referuar nenit 19/1 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se “Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë ligj”.

Sa më sipër, referuar materialeve të administruara, Komisioni i Prokurimit Publik, në zbatim të ligjit për prokurimin publik, i propozon Agjencisë së Prokurimit Publik nisjen e hetimit administrativ në lidhje me konstatimet e mësipërme.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018,

datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Almedical” ShPK, për procedurën e prokurimit “Kërkesë për propozim”, me nr. REF-93446-04-19-2021, me objekt: “Blerje qelqurina”, me fond limit 2.999.702,43 lekë (pa-TVSH) parashikuar për t’u zhvilluar më datë 14.05.2021, nga autoriteti kontraktor Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor, Tiranë.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshme të procedurës së prokurimit.
3. T’i propozojë Agjencisë së Prokurimit Publik nisjen e hetimit administrativ për konstatimet e mësipërme, si edhe të dërgohet pranë APP-së kopje e materialeve të administruara në shqyrtimin administrativ nr. 794 prot., datë 12.05.2021.
4. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 794 Protokolli; Datë 12.05.2021

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fioren Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
AnilaMalaj

Kryetar
Jonaid Myzyri